

LIGJ
Nr.7707, datë 17.5.1993

PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 14.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Mbrojtja e jetës së njerëzve dhe e pronës nga rreziku i zjarrit është detyrë me të cilën, veç organeve të specializuara, ngarkohen ministritë, institucionet e tjera qendrore, organet e pushtetit lokal, si dhe personat e tjerë juridikë e fizikë.

Neni 2

Ministritë, institucionet qendrore, personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, për mbrojtjen nga zjarri ngarkojnë specialistë dhe bashkëveprojnë me organet përkatëse të specializuara të kësaj fushe.

Neni 3

Personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj detyrohen të zbatojnë rregullat e mbrojtjes nga zjarri në të gjitha kategoritë e objekteve, shtetërore a private, të parashikuara nga ky ligj.

KREU II
ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 4

Në Ministrinë e rendit Publik organizohet Inspektoriati i Mbrojtjes nga Zjarri si organ ekzekutiv, qendror i specializuar ushtarak, me uniformë dhe shenjat dalluese përkatëse.

Në rrethe funksionojnë sektorët e Inspektoriatit të MNZ-së në vartësi të këshillit të rrethit, degës së rendit publik dhe Inspektoriatit të MNZ-së në Ministrinë e Rendit Publik.

Neni 5

Në Ministrinë e Mbrojtjes organizohet shërbimi i mbrojtjes nga zjarri me detyrat dhe të drejtat e parashikuara nga ky ligj, brenda objekteve të sistemit të saj.

Neni 6

Inspektoriati i MNZ-së ka si qëllim të sigurojë pacenueshmërinë e personave nëpërmjet parandalimit dhe shuarjes së zjarreve, si dhe dhënies së ndihmës teknike në përgjithësi për fatkeqësi publike.

Neni 7

Veprimtaria e Inspektoriatit të MNZ-së realizohet në çdo kohë dhe shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Objekt i punës së tij janë të gjithë mjediset, ngrehinat, lokalet, veprimtaritë e veçanta, si dhe kompletimi materialo-teknologjik i tyre, pronë e personave juridikë e fizikë vendas e të huaj.

Neni 8

Inspektoriati i MNZ-së në Ministrinë Rendit Publik kontrollon, organizon dhe drejton veprimtarinë e reparteve zjarrfikëse e të inspektorëve të mbrojtjes nga zjarri të të gjitha kategorive, pavarësisht nga vartësia e tyre ekonomike e financiare. Ai përgjigjet dhe merr masa për kualifikimin e personelit zjarrfikës, duke lëshuar për këtë qëllim dëshmitë e aftësisë.

Neni 9

Aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Rendit Publik për mbrojtjen nga zjarri janë të detyrueshme për zbatim nga personat fizikë e juridikë shtetërorë a privatë.

Neni 10

Në qytete, komuna, ndërmarrje, institucione e firma private organizohen grupe vullnetare të specializuara për mbrojtjen nga zjarri. Mënyra e organizimit, e përgatitjes dhe e shpërblimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Inspektoriati i MNZ-së në Ministrinë e Rendit Publik, me kërkesën e personave juridikë a fizikë, vendas ose të huaj, në bazë të një studimi, duke marrë parasysh shtrirjen e zonës së banuar dhe numrin e banesave, shpërndarjen dhe rëndësinë e objekteve, si dhe rrezikshmërinë për zjarr e shpërthim, lidh kontratën për krijimin e reparteve zjarrfikëse brenda objekteve që ata kanë në pronësi e përdorim, dhe kontratën për kontrollin teknik të masave mbrojtëse nga zjarri.

Neni 12

Kontrata për mbrojtjen nga zjarri të objekteve shtetërore me rëndësi kombëtare lidhet me marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik dhe dikasterit përkatës, kurse për objektet e tjera shtetërore e private lidhet ndërmjet Inspektoratit të MNZ-së në rreth dhe personave juridikë e fizikë të interesuar.

Për efekt të këtij ligji, objektet shtetërore me rëndësi kombëtare caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13

Mënyra e lidhjes së kontratës për të gjitha kategoritë e objekteve përcaktohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Shpenzimet për ngritjen, mbajtjen dhe pajisjen e reparteve zjarrfikëse brenda objekteve përballohen nga personat juridikë a fizikë që e kanë në pronësi e përdorim objektin.

Inspektoriatit të MNZ-së i paguhen shpenzimet e bëra për shërbimet që u kryen personave juridikë e fizikë, shtetërorë e privatë. Tarifat dhe lloji i shërbimeve që kryen ky Inspektoriat, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Të ardhurat që realizon Inspektoriati i MNZ-së nga shërbimet që u kryen personave juridikë e fizikë, kalojnë për llogari të këtij Inspektoriati, duke përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave mënyrën e përdorimit të tyre.

Neni 16

Ministria e Rendit Publik organizon përgatitjen dhe kualifikimin e punonjësve për mbrojtjen nga zjarri. Mënyra e përgatitjes së tyre përcaktohet me udhëzim të ministrit të Rendit Publik.

Neni 17

Inspektoriati i MNZ-së, në bashkëpunim me personat juridikë e fizikë, vendas a të huaj, merr masa për prodhimin dhe tregtimin e mjeteve e pajisjeve për mbrojtjen nga zjarri, si dhe miraton licencat e lëshuara për këtë qëllim.

KREU III DETYRAT E ORGANEVE QËNDRORE E LOKALE

Neni 18

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, për mbrojtjen nga zjarri të objekteve të sistemit të tyre, kanë këto detyra kryesore:

- a) Drejtojnë, organizojnë dhe marrin masa për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.
- b) Ushtrojnë kontrolle me specialistë për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore dhe rregullave e normave për mbrojtjen nga zjarri.
- c) Në bashkëpunim me Inspektoriatin e MNZ-së, studiojnë, përcaktojnë dhe nxjerrin rregullat përkatëse për MNZ-në në përshtatje me rrezikun për zjarr, ose për plasje të proceseve teknologjike.
- ç) Organizojnë punën për parandalimin dhe ndjekjen e rregullave të MNZ-së me punonjës të sistemit të tyre.
- d) Studiojnë gjendjen dhe planifikojnë fondet për rikonstruksione dhe kompletimin e objekteve me mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarrit.
- dh) Burimet financiare përballohen nga vetë ndërmarrjet nga buxheti brenda kufirit të programit vjetor.
- e) Planifikojnë dhe dërgojnë në kurse kualifikimi për mbrojtjen nga zjarri punonjës e specialistë të ndryshëm.

Neni 19

Organet e pushteti lokal, për mbrojtjen nga zjarri, kanë këto detyra:

- a) Planifikojnë fonde të nevojshme për ngritjen, mbajtjen dhe pajisjen e reparteve zjarrfikëse në juridiksionin e tyre, sipas kërkesave të nenit 10 të këtij ligji.
- b) Marrin masa për mbrojtjen nga zjarri të ngrehinave, lokaleve e objekteve socialkulturore.
- c) Planifikojnë fonde e kërkojnë vendosjen e mjeteve të ndërlidhjes dhe sinjalizimit publik në rast zjarri.
- d) Organizojnë grupet vullnetare në qytet e fshat për përballimin e zjarreve që mund të ndodhin.
- dh) Nxjerrin akte nënligjore për mbrojtjen nga zjarri, të detyrueshme për zbatim për personat juridikë e fizikë.
- e) Planifikojnë e dërgojnë në kurse kualifikimi për mbrojtjen nga zjarri punonjës e specialistë të ndryshëm brenda e jashtë shtetit.
- ë) Vendosin lidhje dhe bashkëpunojnë me partnerë të huaj për përsosjen e masave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 20

Institucionet, ndërmarrjet, firmat private vendase e të huaja, njësitë e reparteve ushtarake, organizatat e ndryshme etj., për mbrojtjen nga zjarri, kanë këto detyra:

- a) Marrin masa për mbrojtjen nga zjarri të ngrehinave, lokaleve dhe veprimtarive prodhuese.
- b) Kontrollojnë dhe marrin masa për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.
- c) Përcaktojnë rregulla të brendshme për mbrojtjen nga zjarri sipas kategorive të procesit teknologjik të objektit.
- ç) Vendosin mjete sinjalizuese për diktimin e zjarreve në objektet e tyre.
- d) Marrin masa për kompletimin e objekteve me mjetet e nevojshme për shuarjen e zjarrit.
- dh) Sigurojnë ndërlidhje të vazhdueshme.
- e) Mbajnë në gatishmëri rrugët dhe urat për lëvizjen në çdo kohë të automjeteve zjarrfikëse brenda objektit të tyre.
- ë) Me punonjësit e tyre organizojnë grupet vullnetare dhe marrin masa për kualifikimin e tyre.

Neni 21

Personat juridikë e fizikë që veprojnë në sektorin e bujqësisë, detyrohen të marrin masa për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit në pyje, pemishte, ullishte, stalla, kullota etj.

Organizimin dhe drejtimin e veprimtarive për shuarjen e zjarreve në pyje etj., e bëjnë organet përkatëse, në bashkëpunim me Inspektoriatin e MNZ-së.

Neni 22

Personat juridikë e fizikë të minierave dhe energjitikës, në fushën e masave të MNZ-së, kanë këto detyra:

- a) Marrin masa për mbrojtjen nga zjarri të minierave, puseve të naftës, gazit etj., sipas rregulave teknike të nxjerra për këtë qëllim.
- b) Bëjnë studime për parandalimin e fontanave të naftës e gazit, si dhe për përsosjen e metodave e mënyrave të mbylljes së tyre.
- c) Drejtojnë punën për zhdukjen e zjarreve masive (fontanave) në bashkëpunim me Inspektoriatin e MNZ-së.
- ç) Planifikojnë fonde të veçanta çdo vit për sigurimin e pajisjeve të domosdoshme dhe rezervën për përballimin e zjarreve masive.

Neni 23

Personat juridikë e fizikë që veprojnë në sektorin komunal, kanë këto detyra:

- a) Ushtrojnë kontroll dhe ndërhyjnë në marrjen e masave parandaluese të MNZ-së në banesat e shtetasve për instalimet elektrike, oxhaqet etj.
- b) Vendosin sipas normave teknike hidrante zjarrfikëse në rrugët e qyteteve e fshatrave dhe mbajnë në gatishmëri të gjitha burimet e furnizimit me ujë.

Neni 24

Institucionet kulturore detyrohen të marrin masa për mbrojtjen nga zjarri të qyteteve, lagjeve dhe objekteve muzeore.

Neni 25

Ministria e Arsimit në shkollat e mesme e të larta teknike trajton me cikël leksionesh edhe dispozitat ligjore, normat e projektimit dhe rregullat e mbrojtjes nga zjarri. Në shkollat e ciklit të ulët propagandohen në edukatën qytetare edhe problemet e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 26

Personat juridikë e fizikë të transportit dhe komunikacionit kanë këto detyra:

a) Ushtrojnë kontroll e marrin masa për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit në mjetet e transportit detar, rrugor, hekurudhor e ajror dhe në vendqëndrimet e tyre.

b) Kryejnë të gjitha shërbimet teknike për automjetet zjarrfikëse, kur ato e kanë të nevojshme, me përparësi në parqet e ofiçinat.

c) Parashikojnë në projektet për ndërtim ose rikonstruksionin e anijeve masat mbrojtëse nga zjarri dhe impjantet shuarëse.

ç) Planifikojnë, vendosin dhe mirëmbajnë mjete të ndërlidhjes dhe sinjalizimit publik në rast zjarri.

Neni 27

Radiotelevizioni dhe organet e tjera të shtypit, përveç masave që duhet të marrin për mbrojtjen nga zjarri të objekteve të tyre, kanë për detyrë të propagandojnë vazhdimisht problemet që lidhen me mbrojtjen e jetës së njeriut e të pronës nga rreziku i zjarrit.

KREU IV

MASAT MBROJTËSE NGA ZJARRI GJATË PROJEKTIMIT DHE NDËRTIMIT TË VEPRAVE

Neni 28

Projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, rikonstruksioni dhe shtesat në ndërtesat, vepra të ndryshme, linja, makineri e pajisje teknologjike, rrjeti rrugor elektrik e ujësjellës dhe hartimi e zbatimi i planeve të rregullores së qyteteve e fshatrave bëhen në përputhje me rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 29

Specialisti i Inspektoriatit të MNZ-së merr pjesë në miratimin e projekteve nga institutet e projektimit dhe zyrat e urbanistikës në bashki.

Neni 30

Punonjësit e projektimit zbatojnë kërkesat, rregullat e normave të MNZ-së.

Neni 31

Inspektoriati i MNZ-së miraton në çdo rast lejet për sheshin e ndërtimit, anën ndërtimore, teknologjike dhe për fillimin e punimeve të ndërtimit e shfrytëzimit, për çdo objekt e veprimtari të veçantë, kur plotësohen kërkesat e MNZ-së.

Lejet, sipas rrezikshmërisë nga zjarri të objektit, persëriten një herë në 3 vjet ose 6 vjet. Shkallëzimin e rrezikshmërisë e bën Inspektoriati i MNZ-së me projektuesit e objektit.

Neni 32

Në komisionet e kualidimit dhe të marrjes në dorëzim të objekteve merr pjesë edhe specialisti i Inspektoriatit të MNZ-së.

Neni 33

Nuk lejohet fillimi i punimeve dhe bërja e ndryshimeve nga ana funksionale, ndërtimore e teknologjike në objekte nga personat juridikë e fizikë, kur cenojnë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, pa marrë miratimin e Inspektoriatit të MNZ-së.

Neni 34

Specialistët e Inspektoriatit të MNZ-së përgjigjen për miratimin e projekteve në kundërshtim me rregullat. Inspektoriat i MNZ-së në Ministrinë e Rendit Publik ndërhyjnë për zgjidhjen në baza ligjore, kur në projektet e miratuara nuk janë parashikuar rregullat e MNZ-së.

Neni 35

Personat juridikë e fizikë vendas e të huaj, përveç normave të projektimit dhe rregullave të MNZ-së të ministrive e institucioneve nga varen, detyrohen të zbatojnë normat e rregullat e MNZ-së, të ministrive e institucioneve të tjera në objekte që kanë natyrë pune të njëjtë.

KREU V DETYRAT E TË DREJTAT E INSPEKTORIATIT TË MNZ

Neni 36

Inspektoriat i Mbrojtjes nga Zjarri ka këto detyra:

1. Kontrollon në shkallë vendi çdo objekt e veprimtari të veçantë të personave juridikë e fizikë (duke përfshirë objektet e Ministrisë së Mbrojtjes), zbatimin e rregullave të vendosura për mbrojtjen nga zjarri dhe merr masa e lë detyra për mënjanimin e shkeljeve.
2. Jep ndihmën e nevojshme dhe ndërhyjnë në rastet e fatkeqësive publike me njoftimin e personave juridikë e fizikë.
3. Kryen studime për përsosjen e masave të MNZ-së në sektorë të ekonomisë, në bashkëpunim me institucionet shkencore, studiuese e projektuese.
4. Kontrollon zbatimin e rregullave të MNZ-së gjatë projektimit, ndërtimit, rikonstruksionit dhe vënies në shfrytëzim të çdo lloji kategorie objektesh.
5. Ushtron kontroll për transportin e lëndëve djegëse e plasëse.
6. Merr pjesë dhe jep mendime në hartimin e rregullave të MNZ-së që nxjerrin ministrinë, institucionet qendrore dhe organizatat private.
7. Bashkëpunon me gjithë personat juridikë e fizikë, shtetërorë e privatë për zgjidhjen e probleme që dalin në mbrojtjen nga zjarri.
8. Organizon punën dhe merr masa për shuarjen e zjarreve dhe mënjanimin e pasojave.
9. Harton dhe projektin projektaktet normative për mbrojtjen nga zjarri.
10. Në bashkëpunim me dikasteret përkatëse, përgatit aktet e aderimit në organizatat ndërkombëtare që veprojnë për mbrojtjen nga zjarri.
11. Studion dhe analizojnë shkaqet e zjarreve që ndodhin dhe përcaktojnë masat për përmirësimin e gjendjes.
12. Organizon dhe drejton punën për përgatitjen dhe gatishmërinë e reparteve zjarrfikëse.
13. Merr masa për sigurimin e materialeve, të mjeteve e pajisjeve për shuarjen e zjarreve, si dhe planifikon shpërndarjen e tyre në repartet zjarrfikëse.
14. Merr masa për organizimin e bisedave, të konferencave, demonstrimeve praktike, lokale e në shkallë vendi.
15. Ndihmon organet e hetimit në kërkesën e tyre, me cilësinë e ekspertit, për sqarimin e rrethanave e të përgjegjësisë në zjarret e rëna.

Neni 37

Inspektoriat i Mbrojtjes nga Zjarri ka këto të drejta:

1. Miraton, sipas rastit, licencat për ndërtimin e veprave e të objekteve në përputhje me dispozitat e veçanta.
2. Urdhëron largimin menjëherë të materialeve e të lëndëve kur prania e tyre është në kundërshtim me rregullat e mbrojtjes nga zjarri.
3. Bllokun ndërmarrje, reparte pune e prodhimi, institucione, depo e magazina, mjete transporti i objekte të tjera me veprimtari shtetërore e private, kur paraqesin rrezik për zjarr e plasje,

ose në të kundërt vendosen mjetet e shuarjes së zjarrit, ndërlikohet telefonike si dhe mjetet e diktimit e të sinjalizimit.

4. Pezullon nga puna deri në rimarrjen në provë të punonjësve që nuk i kanë njohuritë e duhura ose punojnë në kundërshtim me rregullat e MNZ-së në vende pune me rrezik të theksuar zjarri.

5. Ndërpret energjinë elektrike të linjave të amortizuara, kur ato janë të instaluar në kundërshtim me kushtet teknike dhe paraqesin rrezik për zjarr.

6. Përdor në rast nevojë mjetet e transportit, linjat telefonike dhe çdo pajisje e mjet tjetër të personave juridikë e fizikë që ndihmojnë në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, dhe i shpërblen ata për këtë përdorim.

7. Ndalon trajtimin dhe përdorimin e pajisjeve, të impianteve e linjave që kanë rrezik për zjarr e që nuk janë pajisur me instruksionet përkatëse.

8. Bllokon banesa, zyra, ngrehina e mjedise të tjera ku ka rënë zjarr, për të siguruar të paprekur vendin e ngjarjes.

9. Pezullon punimet e ndërtimit dhe vënien në shfrytëzim të objekteve, kur në to nuk janë parashikuar e zbatuar rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

10. Kallëzon në organet e hetimit për ndjekjen penale personat fizikë përgjegjës, të cilët nuk marrin masat e duhura për zbatimin e rregullave të MNZ-së dhe kur nga ato kanë ardhur ose mund të vijnë pasoja të rënda.

11. Miraton licencat e lëshuara për prodhimin e tregtimin e mjeteve e të pajisjeve zjarrfikëse.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38

Për shkeljet që i bëhen dispozitave të këtij ligji, merren këto masa:

1. Bëhet bllokimi i çdo kategorie objekti për shkeljet e parashikuara në nenet 17 e 22 (shkronja a) 24, 28, 31 e 33.

2. Jepet gjobë me vendim nga 10 000-100 000 lekë për shkeljet e parashikuara në nenet 9, 17 e 20 (shkronjat c,ç,dh) 21, 22 (shkronjat a, ç) 23 (shkronja b) 24, 26 (shkronja b,c,ç) 31 e 33, si dhe:

a) Kur nuk janë zbatuar detyrat e lëna me shkrim.

b) Kur ka rënë zjarr pa pasojë të rëndë dhe për të nuk ka filluar çështja penale.

c) Kur nuk sigurohet ndërlikohet telefonike dhe nuk jepet përparësi në rast zjarri.

3. Jepet gjobë në vend nga 500-10 000 lekë për shkeljet e parashikuara në nenet 3, 20 (shkronjat a, d, e) 23 (shkronja a), 26 (shkronja a) dhe 35, si dhe

a) Kur nuk zbatohen kërkesat e rregullave të brendshme.

b) Kur shtetasit, pa shkaqe të përligjura, nuk pranojnë të japin ndihmë në mjete transporti e ndërlikohet për shpëtimin e jetës së njeriut e të pronës nga zjarri.

c) Kur bllokohen ose pengohen rrugët e lëvizjes së automjeteve zjarrfikës.

Neni 39

Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet nga shefi i Inspektoriatit të MNZ-së, i cili vendos për masën e gjobës.

Neni 40

Kundër vendimit të marrë nga shefi i Inspektoriatit të MNZ-së bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e komunikimit të vendimit në Inspektoriatin e MNZ-së në Ministrinë e Rendit Publik dhe në Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 41

Kur në objektet kombëtare vërehen shkelje të rregullave të MNZ-së, të drejtën e bllokimit, edhe kur ky bllokim ndërpret prodhimin e përgjithshëm, e ka Inspektoriatin e MNZ-së në Ministrinë e

Rendit Publik.

Neni 42

Këshilli i Ministrave, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Mbrojtjes dhe ministrinë e institucionet e tjera qendrore, në bazë për zbatimin e këtij ligji, ngarkohen të nxjerrin akte nënligjore përkatëse.

Neni 43

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.545, datë 3.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.